



Prill 2022

Nr.4

U mbajtë konferenca „Integriteti i zgjedhjeve në mjedisin e ri informativ që na rrethon“



Në organizimin e Fondacionit ndërkombëtar për sistemin zgjedhor (IFES), Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe USAID, më 5 dhe 6 prill në Shkup u mbajt konferenca „Integriteti i zgjedhjeve në mjedisin e ri informativ që na rrethon“, dedikuar mediave dhe rregullimin e tyre në proceset zgjedhore.

Qëllimi i konferencës ishte të nxisë diskutimin midis organizatave qytetare, shoqatave dhe institucioneve nga vendi me palët e interesuara përkatëse nga vendet evropiane për çështje që lidhen me zgjedhjet dhe nëpërmjet përvojave të tyre të ofrojnë rekomandime për përmirësimin e situatës aktuale.

Drejtori i ASHMA-së, dr.Zoran Trajčevski në fillim të aktivitetit iu referua rëndësisë së informimit mediatik gjatë kohës së proceseve zgjedhore dhe aktivitetëve të Agjencisë për monitorimin e mbulimit mediatik zgjedhor të transmetuesve në atë periudhë. Potenco i dhe qëndrimin për heqjen e financimit të reklamave politike me pagesë (RPP) të partive politike nga mjetet e buxhetit shtetëror, nëse kjo nuk është e mundur, partitë të marrin mjete për RPP sipas një modeli të barabartë.

Anëtari i Këshillit të ASHMA-së Zoran Fidanovski përkujtoj për pjesën e detyrimeve për transmetuesit në procesin zgjedhor dhe bëri retrospektivë të disa cikleve zgjedhore për sa i përket rezultateve të monitorimit të përfaqësimit mediatik zgjedhor të transmetuesve dhe rolin e organit rregullator në to.

Në këtë takim u diskutua edhe për ndikimin e dezinformimit dixhital mbi integritetin zgjedhor dhe mënyrat e marrjes me to. Të pranishmit e tjerë ndanë përvoja dhe praktika të mira nga vendet evropiane për përbalimin me dezinformatat dhe lajme të rreme në fushatat zgjedhore, u theksua rëndësia e rregullimit dhe vetërregullimit të medias gjatë procesit zgjedhor, editoriali i pavarur, informim i lirë mediatik pa interesa politike dhe ekonomike.



Dita e dytë e Konferencës mbuloi përvojat e ASHMA-së dhe trupit rregullator për komunikim i Italisë (AGKOM) në aspekt të monitorimit të përmbajtjeve mediatike dhe reklamave politike me pagesë të transmetuesve. Udhëheqësja e Sektorit për punë programore të ASHMA-së mr. Emilija Janevska, shpjegoi procesin dhe aktivitetet lidhur me monitorimin e reklamave politike me pagesë të transmetuesve dhe sfidat me të cilat përballlet Agjencia gjatë cikleve zgjedhore. U prezantuan dhe qëndrimet e ASHMA-së në lidhje me dispozitat e Kodit zgjedhor në lidhje me reklamave politike me pagesë. Përvoja u ndanë edhe nga Komisioni shtetëror për parandalimi e korrupsionit në fushën e transparencës për finansimin e partive politike dhe kampanjave zgjedhore dhe marketingut politik përfshirë këtu dhe reklamimin online.

Disa nga rekomandimet që dolën nga Konferenca kanë të bëjnë me fuqizimin e institucioneve për zgjedhje të ndershme dhe efikase dhe rritje të transparencës së institucioneve dhe partive politike për reduktimin e dezinformatave lidhur me to. U theksua nevoja për bashkëpunim ndërmjet trupave rregullator dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive të punënjësve të tyre, rritjen e ndërgjegjësisë së qytetarëve për mendimin kritik, ndërsa redaktorët dhe gazetarët të vëzhgojnë zyrtarët publik dhe partitë politike dhe nëse nuk i mbajnë premtimet e dhëna t'ju kërkohet përgjegjësi. U konstatua nevoja për një rishikim dhe ndryshim të plotë të Kodit zgjedhor veçanërisht në fushën e reklamave politike me pagesë, që të mos mbeten paqartësi dhe të sigurohet një kuadër rregullator i qëndrueshëm që do vendosë sigurinë juridike, pa ndryshuar Kodin para zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, duhet të rregullohet me ligj edhe mënyra e funksionimit të internet portaleve dhe mënyra e reklamimit nëpërmjet tyre.



NEWSLETTER

Mbikëqyrje mbi radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik

Radiodifuzerët

Mbi të gjithë 109 radiodifuzerë të cilët emetojnë radio program ose televiziv janë realizuar tri mbikëqyrje të rregullta administrative për dispozita të ndryshme ligjore të cilët ishin të detyruar ti realizojnë deri më 31 mars 2022. Mbikëqyrja e parë i referohej obligimin e radiodifuzerëve në programin e tyre ti publikojnë të dhënat për strukturën pronësore, redaktuese dhe burimet financiare në vitin paraprak të dorëzojnë deri te Agjencia në afat prej 15 ditëve. Gjatë kësaj mbikëqyrje nuk u konstatua shkelje nga asnjë medium.

Mbikëqyrja e dytë i referohej detyrimit në një formular të veçantë të parashikuar nga Agjencia për të paraqitur të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin paraprak, totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga ofrimi i aktivitetit dhe shikueshmëria ose audienca mesatare në vitin e kaluar. Nga mbikëqyrja ka rezultuar u konstatua se vetëm Radio Kapitol FM nga Shkupi nuk e ka përbushur këtë obligim në tërësi.

Objekt i mbikëqyrjes së tretë ishte detyrimi për të paraqitur në Agjenci një raport për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në licencën për transmetim radioteleviziv dhe në veçanti për zbatimin e konceptit programor. Nga mbikëqyrja ka rezultuar se këtë obligim ligjor nuk e ka përbushur vetëm TV Iris nga Shtipi.

Për obligimin e respektimit të rregullave për emetim të komunikimit komercial audiovizuel, Mbrojtja e personave të mitur, shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, Emetimi i lojërave të fatit dhe sigurimin e kuizeve ose formave tjera të ndryshme të pjesëmarrjes shpërblyese është realizuar mbi TV Alfa, TV Alsat – M, TV Kanal 5, TV Telma dhe TV Sitel.

Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se në programin e TV Sitel më 22 mars 2022 janë emetuar edicione reprizë dhe premiere i emisionit argëtues dokumentar "Kuzhinë e shpejt" të cilët nuk ishin të shënuar si program në të cilin janë plasuar prodhime.

Të njëjtat media i nënshtrohen gjithashtu mbikëqyrjes së rregullt administrative të detyrimeve që kanë të bëjnë me publikimin e printimit, informacionin që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe publikimin e identifikimit të transmetuesit. Mbikëqyrja ka konstatuar se TV Alsat-M më 22 mars 2022, në disa prej programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat për përshtypjen se televizioni është i detyruar të transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Sipas detyrës zyrtare, në televizionin G-TV është bërë mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore për detyrimet gjatë përdorimit të gjuhës në programet e transmetuesit. Vëzhgimi ka konstatuar se televizioni G-TV i programit të transmetuar më 11 prill 2022, ka transmetuar filmin vizatimor "Pink Panter Pinkozoic Era" me origjinë në anglisht pa ofruar përkthim në shqip, maqedonisht apo turqisht, gjegjësisht gjuhët në të cilat media transmeton një program. në përputhje me licencën.

Pas skadimit të afatit për harmonizimin ligjor, programi i televizionit Alfa i është nënshtuar mbikëqyrjes programore kontrolluese për të përcaktuar nëse televizioni ka vepruar në masën e vërejtjes publike, të dhënë për mosrespektim të rregullave për mbrojtjen e audiençës së mitur. Nga vëzhgimet rezultoi se Alfa TV ka respektuar plotësisht masën e vërejtjes publike.

Mediat e shtypit

Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj 20 botuesve të mediave të shtypura me qëllim që të konstatojë se nëse të dhënat e strukturës së pronësisë i kanë publikuar më së paku në një gazetë ditore, një here në vit, më së voni deri më 31 mars 2022 dhe nëse 15 ditë nga dita e shpalljes nga një pjesë të publikimit ta dorëzojnë të trupi rregullator kopetent. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje të Ligjit për Media.



NEWSLETTER

Operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik

Për obligimet për sipas së cilave operatorët e RRPKE janë të obliguar që në pakon e programore të cilin e rriemetojnë detyrimisht dhe pa pagesë ti përmbajnë serviset programore të servisit radiodifuziv publik, regjistrimi i pakove programore në Agjenci dhe titërimi i programeve të cilat i rriemetojnë operatorët, është kryer mbikëqyrje e regullt programore mbi operatorët Biv Piramoda, Kombo 2003, Skreml dhe Antena AS KTV. Gjatë mbikëqyrjes nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave nga LSHMAAV.

Shqiptimi I masës vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të, mbajtur më 27 prill shqiptoi dy masa vërejtje publike, nga të cilat një për TV Sitel përshkak të shkeljes së obligimeve gjatë plasimit të prodhimeve, ndërsa të dytën për TV Alsat -M përshkak të publikimit të të dhënave për impresum.

Në seancën e 15-të e mbajtur më 15 prill, Këshilli i Agjencisë shqiptoi shtatë masa vërejtje publike. Masë vërejtje publike TV Kanal 5 dhe TV Sitel u është shqiptuar përshkak të emetimit e prodhimeve të komunikimeve komerciale audiovizuale të fshehta, emetimi i spoteve reklamuese dhe spote teleshoppingu në të cilat paraqiten në mënyrë të rreme natyra dhe karakteristikat e produkteve për të cilat ato mashtrojnë publikun dhe janë në kundërshtim me interesat e konsumatorëve dhe për shkak të dhe për shkak të paraqitjes vizuale dhe audio të një personi që prezanton rregullisht lajme dhe emisione informative aktuale.

Maë vërejtje publike për TV 24 Vesti është shqiptuar përshkak të emetimit një emisioni argëtues-dokumentar që nuk është i shenjuar si program në të cilin vendosen produkte, ndonëse produktet e sponsorëve të caktuar janë të përfshirë drejtpërdrejt në aksionin e shfaqjes dhe rekomandohen veçanërisht në mënyrë promovuese përmes mbitheksimit vizual dhe verbal.

